



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1117

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi Brajshori Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “AAB Construction” SH.P.K. dhe ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Muhamet Muciqi ” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I parkut sportiv dhe kendit te lojrave ne lagjen - Prugov”, me numër të prokurimit: 616-25-1614-5-2-1te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Prishtines, me datën 26.12.2025, mori këtë:

Vendim

I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik “Muhamet Muciqi ” B.I. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.11.2025 me numër protokolli 1121/25, si dhe **Aprovohet pjesërisht e bazuar** ankesa e Operatorit Ekonomik “AAB Construction” SH.P.K. e parashtruar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me 12.11.2025 me numër protokolli 1117/25 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I parkut sportiv dhe kendit te lojrave ne lagjen - Prugov” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i lidhur me aktivitetin e prokurimit sipas pikes 1. të këtij dispozitivi.

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës se operatoreve ekonomik si dhe obligohen operatorët ekonomik ankues “AAB Construction” SH.P.K. dhe “Muhamet Muciqi ” B.I. që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 11.03.2025, Komuna e Prishtines në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull ““Ndertimi I parkut sportiv dhe kendit te lojrave ne lagjen - Prugov”” me numër të prokurimit: 616-25-1614-5-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 200,000.00 €.

AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik Euro Comerc ne vlere te përgjithshëm 132,765.88 Euro.

Me 27.10.2025, OE “AAB Construction” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 27.10.2025 po ashtu edhe OE “Muhamet Muciqi ” B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 03.11.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 13/11/2025, OE “AAB Construction” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1117/25. Ndërsa me datë 13/11/2025 OE ““Muhamet Muciqi ” B.I.” “Muhamet Muciqi ” B.I. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 1121/25.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1117/25 dhe ankesa nr. 1121/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AAB Construction” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:Te pa kënaqur me njoftimin e date 22.10.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov me nr. te prokurimit: 616-25-1614-5-2-1 afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK-KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES:

Në mënyrë të kundërligjshme ka shpallur fituese kompaninë e cila duhej të ishte eliminuar në fazën e vlerësimit të ofertave.

Sqarim i detajuar: Më datë 15.08.2025, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar, përmes formularit për zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës, që operatorët ekonomikë të zgjatin vlefshmërinë në përputhje me Rregulloren Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 30.4, ku kërkohet:

- Zgjatja e vlefshmërisë së ofertës (konform FDT-së, neni 21.1), dhe
- Zgjatja e vlefshmërisë së sigurimit të tenderit (konform FDT-së, neni 13.2). Në rastin konkret, është dorëzuar vazhdimi i vlefshmërisë së sigurimit të tenderit në afatin 125-ditësh, si më poshtë nga OE i shpallur fitues “Euro Commerc”.

Ndërkohë, kërkesa në Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) në nenin 13.2 përcakton qartë se vlefshmëria e sigurimit të tenderit duhet të jetë 150 ditë.

Në rastin konkret, kërkesa nuk është përmbushur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues (AK). Si etillë, AK është dashur ta eliminojë kompaninë dhe të mos e favorizojë për shpallje si të përgjegjshme. Egjithë kjo është në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky veprim i Autoritetit Kontraktues përbën shkelje pasi është bërë favorizim i padrejtë ndaj një operatori të caktuar dhe është cenuar parimi i barazisë dhe transparencës në procesin e prokurimit. Shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim: Në dokumentet për Operatorët Ekonomikë, parashihet qartë se operatori ekonomik i propozuar përshpërblim me kontratë është i detyruar që para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues:

Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se: a.) Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale;

Nga qasja në dokumente zyrtare që kishim, kemi konstatuar se nuk është prezantuar asnjë dokument i tillë për drejtuesin tjetër të kompanisë, z. Arbnor Alidema, por vetëm për njërin nga pronarët, z. Enis Alidemi. Duke marrë parasysh që dokumentet e tilla janë të detyrueshme dhe kërkesa e Autoritetit Kontraktues është shumë e qartë, pasi përcakton se ky vërtetim duhet të jetë për çdo drejtues, menaxher ose drejtor të operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues është dashur ta eliminojë këtë operator nga procedura, meqenëse nuk ka përmbushur kërkesën e detyrueshme të dosjes së tenderit.

- Shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim:

Në dosjen e tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar si në vijim: 2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme:

a) Udhëheqës i punishtes – Inxhinier i ndertimit - 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

-Dëshmia e kërkuar dokumentare

-2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i ndertimit ose master i diplomuar.

Te dëshmohet me CV e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt.

Për këtë pozitë, është angazhuar Ing.Sh.Idrizi, si dëshmi për të cilin është paraqitur një Letër Reference nga kompania Electra SHPK. Megjithatë, angazhimi i tij në këtë kompani nuk është evidentuar në CV.

Po ashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference nga kompania Developing Together, e cila gjithashtu nuk është e evidentuar në CV. Ndërsa në Letrën e Referencës nga Pro&Co Group, janë prezantuar projekte që nuk janë pjesë e përvojës së evidentuar në CV. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, rezultohet se kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur. Shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim:

Në dosjen e tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kerkuar si në vijim:2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore temëposhtme-b)Inxhinier i diplomuar i arkitekturës me 3-vite përvojë pune pas diplomimit-Dëshmia e kerkuar dokumentare:2.b),-Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca per punët e mëparshmedhe kontrata e punes me punedhenesin ose marrveshje per ketë projekt.

Për këtë pozitë është angazhuar Ing.A.Morina, i diplomuar më 20.03.2019. Si dëshmi për përvojën e punës, është paraqitur një Letër Reference nga organizata CHËB, mirëpo kjo referencë nuk e përmbush kërkesën për së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Gjithashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference e lëshuar nga vet kompania ofertues – EuroCommerce, megjithatë në CV-në e inxhinierit nuk figuron që ai të ketë qenë ndonjëherë i angazhuar në këtë kompani. Edhe nëse merret një analizë e detajuar e referencës së lëshuar nga EuroCommerce, në të janë të listuara projekte të viteve që nuk përmbushin kërkesën për përvojë pune trevjeçare pas diplomimit. Për shembull, projekti “Restaurimi i Muzeut Komunal” (periudha 16.01.2020 – 20.03.2020) është një projekt në të cilin Ing. Morina ka qenë i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues – CHËB, në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit, dhe jo nga kompania EuroCommerce.Prandaj, EuroCommerce nuk mund të lëshojë referencë për një staf i cili nuk ka qenë i angazhuar nga ana e saj në këtë projekt. Nga analiza e mësipërme rezulton se referenca e paraqitur është e pabazë (fiktive) dhe rrjedhimisht, kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur.Shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim:Në sqarimet shtesë të kërkuara nga AK me datën-14.05.2025- për stafin profesional, kemi parë që nukjanë ofruar informata shtesë për përvojën e punës për stafin e inxhinierëve.Më saktësishta) Udhëheqës i punishtes – Inxhinier i ndërtimit - vite përvojë pune pas diplomimit.b) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës me 3 vite përvojë pune pas diplomimitc) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose bachelor i gjeodezisë me 3 vite përvojë pune pas diplomimit,d) Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikes ose bachelor i diplomuar, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.I gjithë dokumentacioni i ofruar nga ana e Kompanise siq edhe specifikova me larte eshte njeprezantim i cili nuk përmbush kërkesën pasi që janë dokumente që nuk përputhen në mes të CV dheleter-referencës. Andaj AK është dashur që të eliminoj OE në fjalë pasi që nuk ka ofruar dokumente që e dëshmojnë që janë prezantuar informata shtesë për përvojën e punës për stafin e inxhinierëve, përveq atyre që janë dorëzuar me rastin ofertimit.- Shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim:Në dosjen e tenderit

në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar si në vijim:

4.OE Duhet të dëshmojë se ka në dispozicion pajset për realizimin e projektit i)1(Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid).

Për kërkesën në fjalë është prezantuar autobetoniere mikser, mirëpo kjo pajisje shërben vetëm për transportin e betonit, ndërsa kërkesa e dosjes është që automikseri të jetë për prodhimin e betonit. OE ka prezantuar një autobetoniere mikser, e cila përdoret për transportin e betonit të gatshëm nga impianti në vendpunishte. Ndërkohë, kërkesa në dosje është një automikser për prodhimin e betonit, që do të thotë njësi e pajisur me sistem për përzierje dhe prodhim të betonit në vend, jo vetëm për transport. Pra, pajisja e ofruar nuk përmbush kërkesën teknike të përcaktuar në dosje, pasi nuk është për prodhim, por vetëm për transport të betonit.

Paisja e prezantuar nga ana e kompanise te shpallur nga ana juaj si e pergjegjshme e cila nuk e permbush kerkesen. Paisja e prezantuar nga ana jone-automikser per prodhimin e betonit-e cila bene prodhimin e betonit ne punishte-e cila edhe e permbush kerkesen tuaj.

Me vendimin dhe sqarimet që kemi dhënë, shihet qartë se Komisioni i Vlerësimit ka shkelur deklaratën nën betim, në kundërshtim me Nenet 1, 11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092. Komisioni ka dështuar të zbatojë detyrën për të cilën ka nënshkruar deklaratën.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të

transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi

që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Muhamet Muciqi ” B.I. janë parashtruar si në vijim:

Në platformën elektronike e-prokurim - B58 Njoftimi mbi vendimin e AK, për këtë aktivitet të prokurimit, që do të thotë se në këtë rast i shkelur dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rreg. Nr. 001/2022 për PP versioni i konsoliduar, të cilat do i argumentojmë dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkrete në lidhje me këtë ku vonohet vlerësimi nga procesi i hapjes plotë absurditet i lloji i vlerësimit për likuidimin, si dhe plan me ble për 83 ditë, nuk ka arsye logjike dhe as gjatë kohës së lëndëshme. Kjo bie në kundërshtim me nenin 40.3 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP - version i lartmenduar, që specifikon 30 ditë > 20 ditë në rast të arsyetuar, dhe përkundër kësaj AK nuk ka arsyetuar vazhdimin dhe vlerësimin për plotësimin e afateve të përcaktuara. Kjo lëndë është

mjaft humbëse dhe dyshuese për procesin dhe vlerësimin.

ARSYETIMI:

Tenderi është refuzuar për këto arsye:1. Ju si OE nuk keni oferte të papërgjegjshme për arsye se GOE me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës së DT-së dhe njoftimit për kontratë.2. Akomodimi për prodhimin e betonit (me regjistrim valid).Dëshmitë e kërkuara dokumentare:· Një listë e mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë. Pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qira, duhet të dëshmohet edhe me kontratën mbi qiramarjen për këtë projekt. Ju në ofertën tuaj keni paraqitur pasuri tjetër në kundërshtim me këtë kërkesë, për këtë arsye oferta juaj është e papërgjegjshme.

Ky arsyetim nga AK - zyrtari i prokurimit, dëshmon shumë qartë dhe bindshëm se nuk është vlerësuar dhe në qëllim jemi eliminuar, për faktin se teksti tregon ku thotë: “nuk keni ofertë të papërgjegjshme”, që nënkupton se ata e dinë se vërtet kemi ofertë të përgjegjshme. Po ashtu, nuk jemi grupi i OE, por jemi vetëm një OE, etj.

Po ashtu, marrim për bazë edhe Letër standarde të sqarimit të tenderit të datës 14.05.2025, të cilën e kemi pranuar nga AK, përmes platformës elektronike, që kërkon sqarime për staf dhe automikser për prodhim të betonit, si dhe përgjigjen tonë të datës 16.05.2025 ku kemi sqaruar në mënyrë të detajuar sa i përket automikserit për prodhimin e betonit, duke ofruar të gjitha dëshmitë me dokumente dhe regjistrim valid, dhe sqarimin në tërësi për këtë paisje, që do të thotë se jemi në pajtim të plotë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, duke plotësuar në tërësi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor të dhënies së kontratës me çmimin më të ulët dhe të përgjegjshëm.

Ky fakt dhe argumente dëshmojnë dhe argumentojnë se ne kemi plotësuar në tërësi këtë kërkesë të DT-së dhe NJK-së, duke dorëzuar të gjitha dëshmitë lidhur me këtë pajisje, por AK - Komisioni i Vlerësimit, qëllimisht na eliminon dhe në letër standarde të eliminimit nuk ka dhënë asnjë fakt të vetëm se pse ne nuk kemi arritur të plotësojmë këtë kërkesë, pikë të dosjes së tenderit. Por vetëm thotë: “Ju në ofertën tuaj keni paraqitur pasuri tjetër në kundërshtim”. Për këtë arsye oferta juaj është e papërgjegjshme, që bie në kundërshtim me kërkesat e sqarimit dhe dorëzimit të dokumenteve të nevojshme.

Shpresojmë dhe lusim AK të na japë përgjigje konkrete, duke u mbështetur në prova dhe fakte dhe dispozita ligjore, dhe jo vetëm në emocionet dhe pasigurinë pa argumente konkrete.

Përmbledhje e Faktëve:

· Ne kemi dorëzuar të gjitha faktet dhe provat, listën e makinerisë/pajisjeve, marrëveshjen mbi qiranë, librezat e qarkullimit, sigurimin nga kompanitë e sigurimit me regjistrim valid, ashtu siç kërkohej në DT dhe NJK.

· Prova: Dokumentet e dorëzuara për rastin e tenderit, si dhe dëshmitë dhe faktet në sqarimet e kërkuara në letër standarde të sqarimit të tenderit datë 14.05.2025.

AK me rastin e vlerësimit dhe eliminimit të tenderëve në letër standarde të eliminimit ka shkruar dhe bërë një përshkrim të eliminimit pa asnjë fakt apo prova të vetme, duke u mbështetur vetëm në dispozita ligjore që nuk mbështesin këto përshkrime.

Pretendimi

nr.

1

OE: Euro Commmerc O.P. - Viti është i përgjegjshëm për faktin se automikseri i paraqitur nga ky OE për këtë VP nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se ka paraqitur një automikser për transportin e betonit dhe jo një automikser për prodhimin e betonit. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm.

Prove: Libreza e qarkullimit tregon se është autotransportues betoni dhe jo automikser për prodhimin e betonit, ashtu siç kemi dorëzuar ne dhe që tregon se ne kemi dorëzuar automikser për prodhimin e betonit, siç është kërkuar në DT dhe NJK. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm këtë OE për këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj, AK me këto procese të vlerësimit dhe rivlerësimit disa herë ka shkelur dispozitat e LPP-së, duke na diskriminuar dhe duke e zvarritur pa arsye këtë AP.

Pretendimet ankimore kundër OE: Marisa Shpk Gjakovë - NUI: xxxxx596

Pretendimi nr. 1 OE: Marisa Shpk Gjakovë është i përgjegjshëm për faktin se automikseri i paraqitur nga ky OE për këtë AP nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se ka paraqitur një automikser për transportin e betonit dhe jo një automikser për prodhimin e betonit. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm. Prove: Libreza e qarkullimit tregon se është autotransportues betoni dhe jo automikser për prodhimin e betonit, ashtu siç kemi dorëzuar ne dhe që tregon se ne kemi dorëzuar automikser për prodhimin e betonit, siç është kërkuar në DT dhe NJK. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm këtë OE për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet ankimore kundër GOE: DACH Group Shpk; NTVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtinë - NUI: xxxxx617

Pretendimi nr. 1 GOE: DACH Group Shpk; NTVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtinë është i përgjegjshëm për faktin se automikseri i paraqitur nga ky OE për këtë AP nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se ka paraqitur një automikser për transportin e betonit dhe jo një automikser për prodhimin e betonit. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm.

Prove: Libreza e qarkullimit tregon se është autotransportues betoni dhe jo automikser për prodhimin e betonit, ashtu siç kemi dorëzuar ne dhe që tregon se ne kemi dorëzuar automikser për prodhimin e betonit, siç është kërkuar në DT dhe NJK. Andaj, ky fakt e bën të përgjegjshëm këtë OE për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet ankimore kundër GOE dhe OE të cilët kanë tenderuar mbi ofertën financiare të ofertës tonë janë të përgjegjshëm, ashtu siç ka përcaktuar AK në letrat standarde dhe janë palë pa interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së. Në këtë AP, disa tenderues që nuk kanë vazhduar vlefshmërinë e tenderit dhe sigurimin e tenderit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u ceken më lart, rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar as kriteri kryesor për dhënien e kontratës, që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas nenit 61, paragrafi 1 i LPP-së.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë, sepse neve na ka diskriminuar, duke

mos na rekomanduar për kontratë. Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur parasysh as nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, prokurimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Kosovë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 17.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1117/2025 ndersa me daten 17.11.2025 ka autorizuar prap ekspertin shqyrtues per te bere shqyrtimin fillestar te dosjes dhe pretendimeve sipas ankeses me nr. 1121/2025, ndërsa me datë 27.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 1117/25&1121/2025.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “AAB Construction” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1117 kanë vlerësuar si në vijim:

Operatori ekonomik nuk i ka te ndara pretendimet ankimor mirëpo per qellim te trajtimit te ankesës ne i kemi renditur si ne vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr 1. OE ankues tek pretendimi ankimor nr. 1 thekson se AK-Komuna e Prishtinës ka bërë shkelje te nenit 57 te LPP-se sepse OE i rekomanduar për kontratë Euro Commerce, ka berë zgjatjen e validitetit te sigurimit te tenderit per 125 ditë ndërsa AK, ka kërkuar zgjatje te bëhet per 150 ditë.

- Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa ne dosje te tenderit ne lidhje me sigurimin e tenderit është si ne vijim:

- Shuma e Sigurimit të Tenderit është: 3000 Euro për periudhë valide prej në ditë: 150.

OE Euro Commerce ne përmes ofertës ka dorëzuar edhe sigurimin e tenderit me validitet prej 150 dite ne shumen prej 3,000.00€. OE me datë 15.08.2025 përmes E-prokurimit pas kërkesës se AK-Komuna e Prishtines ka bërë zgjatjen e validitetit te tenderit dhe njëkohësisht edhe te sigurimi te tenderit ku sigurimi i tenderit me nr police 142681, i lëshuar me datë 15.08.2025, ka validitet nga data 10.09.2025 deri me datë 13.01.2025 pra është valide për 125 ditë. Konstatojm se sigurimi i tenderit i ofruar fillimisht me dosje te tenderit është ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit andaj vazhdimi tij për këtë periudhë nga data e lëshimi përmbush afatin prej 150 ditë, duke ju referuar edhe deklaratës se OE Euro Commerce te dorëzuar se bashku me sigurimin e tenderit. Nga përshkrimi i mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 1 është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr 2.OE ankues tek pretendimi ankimor nr .2 thekson se: Në dokumentet për Operatorët Ekonomikë, parashihet qartë se operatori ekonomik i propozuar për shpërblim me kontratë është i detyruar që para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues:Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se: a.) Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i sajgjatë dhjetë

viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; Sqarojm se tek Kërkesat e Pershtatshmerisë ne dosje te tenderit kërkesa e AK-së është në vijim: Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është listuar në vendin e dytë. OE Euro Commerce si operator i rekomanduar për kontratë me datë 11.06.2025 ka ngritur në E-prokurim Vërtetimin e ATK-se dhe Çertifikatën e lëshuar nga gjykata me datë 06.05.2025. Nga përshkrimi i mësipërm kostatojm se pretendimi ankimor nr. 2 është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr 3. Sipas pretendimi ankimor nr. 3 OE ankues pretendon se shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim: Në dosjen e tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar si në vijim: 2. Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme: -a) Udhëheqës i punishtës – Inxhinier i ndertimit - 5 vite përvojë pune pas diplomimit. -Dëshmia e kërkuar dokumentare 2. a) OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emëron menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinier i ndertimit ose master i diplomuar. Te dëshmohet me CV e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për këtë projekt. Për këtë pozitë, është angazhuar Ing.Sh.Idrizi, si dëshmi për të cilin është paraqitur një Letër Reference nga kompania Electra SHPK. Megjithatë, angazhimi i tij në këtë kompani nuk është evidentuar në CV. Po ashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference nga kompania Developing Together, e cila gjithashtu nuk është e evidentuar në CV. Ndërsa në Letrën e Referencës nga Pro&Co Group, janë prezantuar projekte që nuk janë pjesë e përvojës së evidentuar në CV. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, rezultohet se kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur.

Sqarojm se Ing Sh. Idrizi sipas dëshmis se diplomës se dorëzuar ne dosje te tenderit ka diplomuar ne vitin 2007 dhe nga dëshmit e ofruara te cilat janë: 1. Letër referenca e lëshuar nga Electra shpk, e datës 05.06.2018 , theksohet se ka punuar nga data 01.02.2017 deri me 30.05.2018. 2. Letër referenca e lëshuar nga Developing Together, e datës Shtator 2018, theksohet që ka punuar nga muaji Maj 2010 deri Dhjetor 2011. 3. Letër referenca e lëshuar nga Pro & Co Group, e datës 31.12.2022, nuk specifikohet periudha e punës tek ky operator ne letër referenc mirëpo në CV e ofruar te cilën e ka nënshkruar edhe vete inxhinieri përmes dosjes se tenderit theksohet se nga viti 2014-vazhdon , te punoj tek Pro& Co Group , shih ne vijim: Autoritetet Kontraktuese ne rast te dyshimeve te caktuara mbi vërtetësin e dokumenteve te ofruara mund te kërkojn sqarime apo dëshmi shtesë te operatoret ekonomik për te vërtetuar dokumentacionin e dorëzuar nga operatoret ekonomik përmes dosjes se tenderit. Andaj bazuar ne dëshmit e lartcekura të dorëzuara përmes dosjes se tenderit inxhinieri i kërkuar plotëson përvojën e punës prej 5 vite pas diplomimit. Nga përshkrimi i mësipërm kostatojm se pretendimi ankimor nr. 3 është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 4. Sipas pretendimi ankimor nr. 4 OE ankues pretendon se shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim: Në dosjen e tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar si në vijim: 2.Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:b)Inxhinier i diplomuar i arkitekturës me 3-vite përvojë pune pas diplomimit-Dëshmia e kërkuar dokumentare-2.b),-Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punedhënesin ose marrveshje për këtë projekt. Për këtë pozitë është angazhuar Ing.A.Morina, i diplomuar më 20.03.2019.Si dëshmi për përvojën e punës, është paraqitur një Letër Reference nga organizata CHËB, mirëpo kjo referencë nuk e përmbush kërkesën për së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Gjithashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference e lëshuar nga vet kompania ofertues – EuroCommerce, megjithatë në CV-në e inxhinierit nuk figuron që ai të ketë qenë ndonjëherë i angazhuar në këtë kompani. Edhe nëse merret një analizë e detajuar e referencës së lëshuar nga EuroCommerce, në të janë të listuara projekte të viteve që nuk përmbushin kërkesën për përvojë pune trevjeçare pas diplomimit. Për shembull, projekti “Restaurimi i Muzeut Komunal” (periudha 16.01.2020 – 20.03.2020) është një projekt në të cilin Ing. Morina ka qenë i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues – CHËB, në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit, dhe jo nga kompania EuroCommerce. Prandaj, EuroCommerce nuk mund të lëshojë referencë për një staf i cili nuk ka qenë i angazhuar nga ana e saj në këtë projekt. Nga analiza e mësipërme rezulton se referenca e paraqitur është e pabazë (fiktive) dhe rrjedhimisht, kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur.Sqarojm se Ing. A. Morina, sipas dëshmive të diplomës së dorëzuar përmes dosjes së tenderit ka diplomuar me datë 30.03.2019 ndërsa referenca e lëshuar nga CHËB e datës 08. June 2020 i referohet periudhës së punës nga viti 2015 pra para datës së diplomimit mirëpo nuk i referohet askund datës së përfundimit të bashkpuimit në mes inxhinierit dhe organizatës CHËB andaj si e till nuk mund të konstatojm saktë periudhën e përvojës së punës prej 3 vite.Letër referenca e lëshuar nga OE Euro Commerce e datës 11.06.2022 , po ashtu nuk i referohet periudhës së fillimit dhe mbarimit të bashkpumimit në mes të inxhinierit z. Morina dhe OE Euro Commerce dhe si e tillë nuk mund të konstatohet saktë përvoja e punës minimum tri vite pas diplomit sipas kërkesës së dosjes së tenderit.Bazuar në dëshmitë e lartcekura të referencave të dorëzuara përmes dosjes së tenderit inxhinieri i kërkuar nuk konstatohet saktë përvoja e punës prej 3 vite pas diplomimit dhe si e tillë në këto raste autoritetet kontraktuese mund të bejnë sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë sipas nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38 të Rr. PP nr 002/2024.Nga përshkrimi i mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 4 është pjesërisht i bazuar.

*Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 5.*Shkelje tjetër sipas OE tek pretendimi ankimor nr 5,është se Autoriteti Kontraktues është si në vijim:Në sqarimet shitesë të kërkuara nga AK me datën-14.05.2025- për stafin profesional, kemi parë që nuk janë ofruar informata shitesë për përvojën e punës për stafin e inxhinierëve.Më saktësishta) Udhëheqës i punishtës – Inxhinier i ndërtimit - 5 vite përvojë pune pas diplomimit.b) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës me 3 vite përvojë pune pas diplomimitc) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose bachelor i gjeodezisë me 3 vite përvojë pune pas diplomimit,d) Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose bachelor i diplomuar, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.I gjithë dokumentacioni i ofruar nga ana e Kompanisë siq edhe specifikova më lartë është një prezantim i cili nuk përmbush kërkesën pasi që janë dokumente që nuk përputhen në mes të CV dhe leter-referencës. Andaj AK është dashur që të eliminojë OE në fjalë pasi që nuk ka ofruar dokumente që e dëshmojnë që janë prezantuar informata shitesë për përvojën e punës për stafin e inxhinierëve, përveq atyre që janë dorëzuar me rastin ofertimitSa i përket për dy personat udhëheqës u punishtës dhe inxhinier i diplomuar i

arkitekturës i kemi trajtuar tek pretendimet me lartë.: -Inxhinieri i Gjeodezisë nga dëshmit e ofruara rezulton se ka diplomuar ne vitin 2011, po ashtu ka dorëzuar Letër referenca nga operatori ekonomik GEO MAP, ku theksohet qe ka angazhim tek ky operator nga data 01.09.2013 e deri me sot. Po ashtu ka te dorëzuar letër referencën nga OE Pro&CO Group te datës 21.05.2018 dhe nga OE NPN Lori e datës 01.10.2013. Andaj nga këto letër referenca rezulton se përvoja e inxhinierit është mbi 3 vite pas diplomimit. -Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes, ka dorëzuar letër referenc nga OE Pro&CO Group te datës 20.11.2023, mirëpo ne letër referencë nuk theksohet data e fillimit te bashkëpunimit ne mes te OE dhe inxhinierit te elektroteknikes ndërs anbe CV theksohet se angazhimi i inxhinierit tek OE Pro&CO Group është nga vitit 2021, 2024-vazhdon. Po ashtu ka dorëzuar letër referenc nga OE RISA MONT SHPK te datës 05.08.2020, ku theksohet se është i anagzhuar nga viti 2019 –vazhdon. Nga dëshmia e diplomës se dorëzuar konstatojm se inxhinieri i elektroteknikes ka diplomuar ne Korrik te vitit 2008 andaj ne bazë te këtyre dëshmime rezulton se përvoja e inxhinierit te elektronikes pas diplimit është mbi tri vite. Autoritetet Kontraktuese ne rast te dyshimeve te caktuara mbi vërtetësin e dokumenteve te ofruara mund te kërkojn sqarime apo dëshmi shtesë te operatorët ekonomik për te vërtetuar dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomik përmes dosjes se tenderit. Nga përshkrimi i mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 5 është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 6. Sipas OE ankues shkelje tjetër që nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktues është edhe si në vijim: Në dosjen e tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kerkuar si në vijim: 4.OE Duhet të dëshmojë se ka në dispozicion paisjet për realizimin e projektit i) 1.(Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid). Sqarojm se OE i rekomanduar per kontratë ne lidhje me këtë pajisje ka ofruar certifikatën e rexhistrimit të automjetit me nr regjistrimi 01-721-SG dhe kontratën e nënshkruar me OE Pro&Co Gruop shpk. Këto dokumente gjenden ne fajlin me emërtim “6. Makineria.rar - RAR archive, unpacked size 1,850,922 bytes”. AK-ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar te ofrohet si dëshmi fotot e pajisjeve ne këtë rasta andaj e kemi te pa mundur te bëjmë nje krahasim ne mes te pajisjes se ofruar nga OE ankues dhe pajisjes se ofruar nga OE i rekomanduar per kontratë. Ne certifikatën e regjistrimit te automjetit shkruan Autobetonier mikser me dy dyer ndërsa ne dosje te tenderit shkruan Auto mikser per prodhimin e betonit andaj nga te dy emërtimet ne cilesin e ekspertit shqyrtues nuk mund te kontatohet e kundërta sepse kërkesa dhe dëshmia ne dosje te tenderit është dashur te jetë me e qartësuar dhe e dokumentuar edhe me foto te pajisjeve dhe me përshkrime me te detajuara teknike duke kërkuar informacione me te shumta ne lidhje me pajisjen e kërkuar nga AK ne dosje te tenderit. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm rekomandojm AK-Komuna e Prishtines qe ne fazën e ekzekutimit te kontratës te bëjë mbikëqyrjen e vazhdueshme te ekzekutimit te kontratës dhe te ofrimit te pajisjeve sipas kërkesave te kërkuara ne dosje te tenderit, po ashtu është në përgjegësin e komisioneve profesionale te vlerësimit te formuara nga ana e autoriteteve kontraktuese te bëjnë konstatimin e nje gjendje faktike ne raport me kërkesat e dosjes se tenderit. Nga përshkrimi i mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 6 është pjesërisht i bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Secili Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë

me Ligjin për Prokurim Publik.

Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, dosjes së tenderit, dallimin në çmim në mes OE të rekomanduar dhe OE ankues ku rezultoi se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka çmim më të ulët se OE ankues andaj sipas nenit 6 të LPP-së rekomandojmë Panellin Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar por të mbetet në fuqi vendimi i AK-së mbi dhënien e kontatës i datës 22.10.2025

Lidhur me pretendimet e OE “Muhamet Muciqi” B.I. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1121 kanë vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik ankues pretendon se; Duke marrë për bazë se AK – ZPP me rastin e nxjerrjes së B58 njoftimit mbi vendimin e datës 22.10.2025 nuk na ka njoftuar përmes letrës standarde se jemi GO të pasuksesshëm apo/ose të eliminuar në po përsërisim pretendimin tonë se jemi GOE të përgjegjshëm dhe plotësojmë/posedojmë pajisjen “automikser për prodhimin e betoni” ashtu siç është kërkuar në Dt dhe NJK si dhe kemi argumentuar përmes sqarimeve të kërkuar nga AK në vlerësimin fillestar..... Me fjalë tjera ne besojmë se AK do të reflektojë dhe të veprojë në pajtim të plote me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje duke kërkuar AK të kthejë në rivlerësim dhe të na rekomandojë për dhënie të kontratës pasi që ne kemi tenderuar me çmimin më të lirë dhe të përgjegjshëm, andaj AK – ZPP me rastin e eliminimit tonë dhe anulimi i AP është në shkelje të nenit 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-së dhe parimit kryesor të prokurimit “vlera për para”. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të paraqitur nga Operatori Ekonomik ankues dhe pas analizimit të përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK), Eksperti Shqyrtues vlerëson si vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur në dosje, rezultoi se ankuesi ka ngritur pretendime lidhur me mosrespektimin e procedurave të njoftimit, si dhe për vlerësimin jo të plotë të dokumentacionit teknik dhe profesional të ofertës së tij. Në anën tjetër, Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij, nuk ka ofruar prova të mjaftueshme se ka zhvilluar proces të plotë të verifikimit të dokumentacionit, sidomos në raport me pajisjen “automikser për prodhimin e betonit”, si dhe nuk ka argumentuar mjaftueshëm kriteret mbi bazën e të cilave ka arritur në konkluzionin përfundimtar gjatë vlerësimit të ofertave. Duke marrë parasysh këto rrethana, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor duhet të aprovohet pjesërisht, ngase në këtë fazë nuk provohet se ekziston parregullsia e tillë që të çonte drejtpërdrejt në zgjidhje përfundimtare të çështjes, por njëkohësisht vërehen mangësi në procesin e vlerësimit nga ana e AK-së.

Prandaj, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave, të kërkojë sqarime plotësuese nga operatori ekonomik ankues, në përputhje me nenin 72 (Sqarimi i ofertave) dhe nenin 59 (Vërtetimi i përputhshmërisë me kriteret e kualifikimit) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Këto sqarime duhet të sigurojnë që vlerësimi final të jetë i plotë, i drejtë dhe i bazuar në të gjitha provat relevante të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Gjatë rivlerësimit të ofertave, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të kërkojë nga operatori ekonomik i rekomanduar si dhe OE ankues sqarime shtesë lidhur me prezantimin “automikser për prodhimin e betonit” si dhe librezën e qarkullimit të automikserit për prodhimin e betonit, me qëllim të vërtetimit nëse kjo pajisje ka qenë e regjistruar dhe valide për qarkullim në momentin e ofertimit, ashtu siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Ky verifikim duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 72 dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, për të siguruar vlerësim të plotë, të drejtë dhe të bazuar në dokumentacion të verifikuar.

Ky veprim siguron transparencë, respektim të procedurave ligjore, trajtim të barabart të palëve në procedur dhe mundëson që AK të marrë vendim të argumentuar dhe të paanshëm, në përputhje me parimet themelore të LPP-së dhe parimin “vlëra për para”.

Përgjigje në pretendimi nr2. Operatori Ekonomik Ankues pretendon se Automikseri i prezantuar nga OE: Euro Commerc O.P. - Viti, i rekomanduar për këtë AP nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se ka prezantuar një automikser për transportin e betonit dhe jo një Automikser për prodhimin e betonit, Prove libreza e qarkullimit dëshmon se është autotransportues betoni dhe jo atomikser për prodhimin e betonit ashtu siç kemi dorëzuar ne dhe qe dëshmon se ne kemi dorëzuar atomikser për prodhim betoni ashtu siç është kërkuar ne DT dhe NJK, andaj ky fakt e bën te papërgjegjshëm. Pas shqyrtimit të detajuar të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik ankues, si dhe provat e prezantuara gjatë shqyrtimit administrativ të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton sa vijon:

Nga analiza e ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, rezulton se mjeti i ofruar – automikseri – është automikser për transport të betonit, ndërsa sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit (DT) dhe Njoftimit për Kontratë (NJK), Autoriteti Kontraktues ka kërkuar automikser për prodhimin e betonit. Kjo mospërputhje esenciale e bën ofertën e OE të rekomanduar të papërgjegjshme, për shkak të mosrealizimit të kërkesave teknike të detyrueshme të tenderit.

Këtë mospërputhje e dëshmon edhe libreza e qarkullimit e mjeteve të ofruara, e cila qartësisht identifikon mjetin si autotransportues betoni dhe jo si automikser për prodhimin e betonit, ashtu siç kërkohet në DT. Në bazë të vlerësimit të provave dhe analizës së dokumentacionit, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr3. Operatori Ekonomik Ankues pretendon se Automikseri i prezantuar nga GOE: DACH Group spk; NIVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtine, për këtë AP nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se e ka prezantuar një automikser për transportin e betonit dhe jo një Automikser për prodhimin e betonit, andaj ky fakt e bën te papërgjegjshëm, Prove libreza e qarkullimit dëshmon se është autotransportues betoni dhe jo atomikser për prodhimin e betonit ashtu siç kemi dorëzuar ne dhe qe dëshmon se ne kemi dorëzuar atomikser për prodhim betoni ashtu siç është kërkuar ne DT dhe NJK, andaj ky fakte e bën te papërgjegjshëm këtë OE për këtë aktivitet te prokurimit. Pas shqyrtimit të detajuar të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik ankues, si dhe provat e prezantuara gjatë shqyrtimit administrativ të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton sa vijon;

Nga analiza e ofertës së GOE: DACH Group spk; NIVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtine , rezulton se mjeti i ofruar – automikseri – është automikser për transport të betonit, ndërsa sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit (DT) dhe Njoftimit për Kontratë (NJK), Autoriteti Kontraktues ka kërkuar automikser për prodhimin e betonit. Kjo mospërputhje esenciale e bën ofertën e GOE: DACH Group spk; NIVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtine, të papërgjegjshme, për shkak të mosrealizimit të kërkesave teknike të detyrueshme të tenderit. Këtë

mospërputhje e dëshmon edhe libreza e qarkullimit e mjeteve të ofruara, e cila qartësisht identifikon mjetin si autotransportues betoni dhe jo si automikser për prodhimin e betonit, ashtu siç kërkohet në DT. Në bazë të vlerësimit të provave dhe analizës së dokumentacionit, ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Eksperti shqyrtues rekomandon që Autoriteti Kontraktues duhet ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe që gjatë procesit të rivlerësimit: të kryejë sqaroime të nevojshme ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, të sigurojë në mënyrë të paanshme dhe të plotë se ofertat e OE-ve kanë përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit, si në aspektin teknik ashtu edhe në përputhshmërinë e dokumentacionit të dorëzuar.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore lidhur me ankesën me numer 2025/1117 PSH konstaton se

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin të plote ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatoreve ekonomik ankues, mirëpo bazuar në dokumentacionin e ofruar nga OE ankues si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar po ashtu përgjigjeve të dhëna nga ana e ekspertit në raportin e tij, kërkesat e vendosura në DT, përgjigjeve të dhëna në vendimin e AK lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues si dhe dallimin në oferte sa i përket çmimit të ofruar në

mes te OE ankues dhe OE te rekomanduar, PSH konstaton se AK ka vepruar ne përputhshmëri me dispozitat ligjore te LPP-se, kështu duke respektuar te gjitha kërkesat e vendosura ne DT.

Andaj bazuar në te gjitha provat te permendura si mesiper pa pasur nevoj te perseriten Paneli Shqyrtues aprovon si te pjaserishme ankesen e OE ankues dhe verteton vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me dhënien e kontates te datës 22.10.2025.

Lidhur me pretendimet ankimore lidhur me ankesen me numer 2025/1121 PSH konstaton se:

Ankues ka ngritur pretendime lidhur me mosrespektimin e procedurave të njoftimit, si dhe për vlerësimin jo të plotë të dokumentacionit teknik dhe profesional të ofertës së tij, ne pergjithsesi , kështu edhe eksperti në raportin e tij ka dhënë një përgjigje të përgjithshme duke konstatuar se në këtë fazë nuk provohet se ekziston parregullsia e till, megjithatë PSH konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar ngase në platformën E-prokurimi vërtëtohet se AK ka bërë vlerësimin në përputhje të plotë me dispozitat ligjore e ne veqanti me dispozitat ligjore të nenit 1, nenit 6 dhe nenit 7 të LPP-së, me çka vërtëton se aktivitetin e ka kthyer në rivlerësim ka bërë sqarimet e duhura në përputhje me parimet bazë të prokurimit publik.

Po ashtu, vlenë të theksohet edhe fakti se neni 72 i LPP, nuk i vë karakter detyrimi AK që të kërkoj sqarime, ngase ka shprehjen "mund". Paneli sqaron se po ashtu se në vështirësi të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventuale, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit te percaktuar.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e dyte ankimor ku ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar automikseri i cili nuk është në pajtim me DT dhe NJK, për faktin se ka prezantuar një automikser për transportin e betonit dhe jo një Automikser për prodhimin e betonit, si dhe lidhur me pretendimin e trete ankimor të parashtruar nga OE ankues, PSH konstaton se lidhur me keto pretendime ankimore vlerëson faktin se AK ka bërë dy herë vlerësimin e ofertave për të cilat ka angazhuar edhe komisionin e vlerësimit të që do të thotë se janë dy vendime nga dy komisioneve të një pasnjëshme dhe këto komisione të cilat supozohen të jenë profesionale konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”, atëherë në kuptim të nenit 1 dhe nenit 6 të LPP-së dhe me qëllim që mos të prolongoj më tepër aktivitetin e prokurimit edhe më tepër dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se ne zbatim të dispozitës ligjore të nenit 59 par.4 që përfshin devijimet e vogla është në vlerësimin e AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontrates edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli Shqyrtues thekson faktin se është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues për të bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave por edhe dhënien e kontratave të prokurimit publik. Paneli Shqyrtues dhe aq më pak ekspertët shqyrtues nuk mund të lëshohen në vlerësimin e ofertave por vetëm gjykojnë nëse veprimet e AK janë në përputhje ose jo me

dispozitat në fuqi të LPP dhe legjislacionit sekondar për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik sipas numerit rendor 2025/1117 duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar si dhe ankesa e Operatorit Ekonomik sipas numerit rendor 2025/1112 duhet të miratohet po ashtu vetëm si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të ta vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Nderimi I parkut sportiv dhe kendit te lojrave ne lagjen - Prugov” me numër të prokurimit: 616-25-1614-5-2-1 .

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K., Muhamet Muçiqi**
- Arkivës së OSHP-së: